



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE

Adresa: Bashkia Kolonje "Sheshi Rilindja"7401 Erseke, Kolonje Albania, Web: www.kolonja.gov.al, Email : info@kolonja.gov.al

PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE: 14 SHTATOR 2022

VENDI: *Qyteti Leskovik*

ORA: *12:00*

Tema e Konsultimit: *Mbledhja e Rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per hartimin e buxhetit per vitin 2023.*

Baza Ligjore: *Ne mbeshtetje dhe ne zbatim te Ligjit Nr.146/2014 "Per njoftimin dhe Konsultimin Publik" neni 11 pika 2, Ligji Nr. 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore" neni 34, Ligjit Nr.68 /2017 "Per financat e veteqerisjes vendore", ligjit nr.9936, date 26.06.2088, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar,ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.*

Pjesemarres : *Kryetari Erion Isai, nenkryetari Amarildo Jaho, Drejtor i sherbimeve publike Ermal Zylfo, drejtori i bordit te kullimit Sotiris Veiz si dhe administratori i Leskovikut Leonard Konica .*

Mbledhja u be per realizimin e buxhetit , puneve dhe detyrave ne njesine Leskovik , kete 8 mujor dhe cfare do te behet tre vitet e ardhshme. Ishin te pranishem familjare te fshatrave te ndryshem. Takimin e hapi kryetari i Bashkise i cili i diskutoi investimet qe do te behen ne Leskovik si me poshte: Brenda 10 diteve asfaltim i pjeseve rrugore.

- Ndricimi LED
- Rikonstruksion i Qendres Kulturore
- Nderhyrjet tek terrenet sportive

- Zgjerimi i pedonales
- Rruga Erseke-Leskovik do perpjestohen punimet
- Rruga e llixhave do te behet me asfaltin dhe me dy parkime.
- Do filloje rikonstrukcioni i konviktit per zairete e dimrit.

Pyetje: Z.Apostos Cipi

Kemi problem rrushin dhe rakine, ka ngelur stok

- **Kryetari :**

Do te hapet kantina dhe do te grumbulloje rrush. Problemi eshte NIPTI fermerit dhe certifikimi i mallit ne fature.

- **Z.Mandi Suloni**

Kemi problemin e rikonstrukcionit te shtepise.

Problemi i lejes per drute e zjarrit sa te vije leja nga ministria ne 1 Tetor i ftohti fillon shpjet dhe eshte vone.

- **Z.Ajdin Ajdini**

Nuk kemi uje te pijshem, vazhdon ta kemi problem, ka patur difekte dhe presim te behen riparime.

Tjeter problem eshte se nuk kemi veteriner ne Leskovik, por nuk ka aplikimie per vend pune.

- **Z.Ladi Vezuli**

Duhet kaluar uji ne xhade per sperkatje parcele me parcele, te vendoset dhe tub.


- **Z.Astrit Hako**

Mirembajtja e rrugeve eshte problem si dhe vaditja e lulishteve. Duhet nje usta dhe kanal vadites. Nga viti tjeter Leskoviku do marre pavaresi makine dhe kamion.

- **Z.Labo Shyla**

Deri tani nuk jane bere pune te mira, hyrja e qytetit do goxha pune, trotuarer jane prishur dhe demtuar.

FOTO – GALERIA E TAKIMIT



Per te shikuar te plote galerine e takimit kliko linkun:

<https://konsultimivendor.al/degjesat-mbi-buxhetin-2023-bashkia-kolonje-nj-a-leskovik/>

Hartoi dhe mbajti kete procesverbal:

Sofika Rexhepi

Sekretare e pergjithshme

Bashkia Kolonje